



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 211/1 Prot

Tiranë, me 25.03 / 2015

**Lënda:** *Jepet mendim mbi draft-udhëzimin "Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale"*

**Drejtuar:** **Z. Plarent NDRECA**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE**  
**SPORTIT**

Tiranë

Në përgjigje të shkresës Nr.1979 Prot., datë 12.03.2015, dhe në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, në draft-udhëzimin e përcjellë për mendim janë përfshirë një tërësi rregullash konform ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa sugjerohet si vijon:

- Përmbajtja e pikës 2 të riformulohet duke evidentuar më qartë dhe në mënyrë më specifike qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.
- Të përcaktohen përkufizimet e termave të përdorur në përmbajtje të draftit, si psh, cili është "kontrollues", "përpunues" i të dhënave personale, "subjekt i të dhënave personale", cilat janë "të dhënat sensitive" që do të mblidhen dhe përpunohen nga institucionet arsimore parauniversitare, sipas kategorive të subjekteve.
- Përmbajtja e shkronjës "c" të pikës 5 të riformulohet. Pavarësisht se në të, parashikoni se nuk do të mblidhni dhe përpunoni të dhëna sensitive, sipas shkronjës "b", parashikoni se mblidhni "kartelat e vaksinimeve". Megjithë këtë, ju duhet të saktësoni se çfarë të dhënash të tjera shëndetësore mblidhni, si p.sh "raportet mjekësore" të subjekteve të të dhënave, "vërtetimin e gjendjes gjyqësore" për punonjësit, etj.
- Përpunimi i të dhënave sensitive, duhet parashikuar në këtë draft-udhëzim në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
- Në shkronjën "c" të pikës 13, fjala "person" të zëvendësohet me togfjalëshin "subjekt i të dhënave, prindi ose kujdestarë i ligjshëm".

- Afati i parashikuar në shkronjën “a” të pikës 16 duhet të jetë në përputhje me pikën 2 të nenit 13 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sipas të cilit parashikohet se “*Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e bllokimit, korrigjimit apo të fshirjes*”.
- Titulli i pikës 17 të zëvendësohet me togfjalëshin “Transmetimi dhe Arkivimi i dosjeve të të dhënave”.
- Në pikën 20, të përcaktohet emërtesa e saktë e Komisionerit në “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Shtojca 1 të titullohet në përputhje me përmbajtjen e saj.
- Titulli i Shtojcës 2/1 dhe 2/2 të specifikohet kujt subjekti i drejtohet deklarata, në përputhje me përmbajtjen e saj.
- Në përmbajtje të këtyre deklaratave të parashikohet informim më i plotë për subjektin, qëllimin e përpunimit, kohën e mbajtjes së të dhënave personale, etj. (*referojuni për këtë nenit 18 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe pikës 24 të nenit 3 të këtij ligji*).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

